



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 2 nëntor, në bazë të urdhrit për arrestim të lëshuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, z. Isni Kilaj u arrestua në Kosovë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar me mbështetjen e policisë së Kosovës dhe të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Sipas Ligjit, policia në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që i janë dhënë policisë së Kosovës sipas ligjeve të Kosovës.

Urdhri për arrestimin e Isni Kilajt u lëshua nga Prokurorja e Specializuar për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përfshirë pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës.

Më 3 nëntor, z. Kilaj u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë në bazë të Urdhrit për Transferim të lëshuar nga Gjykatësi i Vetëm i Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Sipas Ligjit, kushdo që arrestohet në bazë të urdhrit të Prokurorit të Specializuar, nxirret para një gjykatësi të Dhomave të Specializuara brenda 48 orësh pas arrestimit të tij. Rrjedhimisht, të shtunën, 4 nëntor, u mbajt paraqitja e parë e Isni Kilajt para Gjykatësit të Vetëm të DHSK-së. Seanca ishte publike gjatë së cilës Gjykatësi siguroi që z. Kilaj ishte informuar për arsyet e arrestimit të tij dhe që të drejtat e tij sipas Ligjit dhe Rregullores, ndër të cilat e drejta për përfaqësim juridik, ishin respektuar.

Të hënën, 6 nëntor, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Kilaj, pasi konstatoi se ekziston dyshim i bazuar se i dyshuari kreu vepra penale kundër administrimit të drejtësisë që përfshihen në juridiksionin e DHSK-së. Për shkak të rrezikut të arratisjes dhe rreziqeve të tjera të paraqitura në vendim, Gjykatësi e gjykoi të përshtatshëm vazhdimin e paraburgimit. Gjykatësi vuri në dukje gjithashtu se hollësitë e mëtejshme në lidhje me arsyetimin në të cilin bazohet ky vendim do të jepen në një vendim të mëvonshëm, deri më 9 nëntor 2023.

Vendimin e Gjykatësit të Vetëm mbi Vazhdimin e Paraburgimit, si edhe Versionin e Redaktuar Publik të Urdhrit për Transferim mund t'i gjeni në arkivin e dokumentacionit gjyqësor publik në faqen e internetit të DHSK-së.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, dëshmitari i 32-të i thirrur nga Prokuroria, z. Predrag Dediq, përfundoi dhënien e dëshmisë të enjten e kaluar, 2 nëntor. Të hënën, më 6 nëntor, z. Gjergj Dedaj, dëshmitari i 33-të i thirrur nga Prokuroria, filloi dhënien e dëshmisë dhe e përfundoi atë pas pyetjeve të Prokurorisë dhe pasi u mor në pyetje nga dy prej katër ekipeve të Mbrojtjes dhe nga Trupi Gjykses. Dëshmitari i 34-të, Dragan Ivanisheviq, filloi dhënien e dëshmisë sot paradite.





Të martën, më 7 nëntor, gjatë seancës në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, Trupi Gjykes lëshoi një urdhër gojor i cili ka për qëllim që gjykimi në këtë çështje të zhvillohet sa më shumë në seancë publike. Ky urdhër gojor vjen pas një urdhri të mëhershëm të Trupit Gjykes këtë vit, që i udhëzonte palët të mbanin parasysh parimin procesit publik dhe të paraqitnin sugjerime konkrete për siguruar një shkallë më të madhe të mbajtjes së gjykimit në seanca publike, duke pasur parasysh numrin e seancave private dhe të mbyllura.

Në përputhje me urdhrin e kësaj jave, palët do të rishikojnë transkriptet e gjykimit nga seancat private brenda afateve të caktuara. Ky vendim vlen për transkriptet e kaluara si dhe për të gjitha transkriptet e ardhshme. Krahas kësaj, si rregull i përgjithshëm, palët duhet ta identifikojnë mjaftueshëm një dëshmitar të mbrojtur ose informacion konfidencial në secilën kërkesë për redaktim të informacionit. Kur ta bëjnë këtë, ata duhet të mbajnë parasysh nevojën për të siguruar që gjykimi të zhvillohet sa më shumë në seanca publike, ndërkohë që sigurojnë mbrojtje efektive për ata që të cilëve u janë miratuar masa mbrojtëse.

Trupi Gjykes paraqiti edhe një masë, me anë të së cilës palët do të dorëzojnë njëkohësisht versionet e redaktuara publike dhe versionet konfidenciale të parashtrimeve, përveç nëse ka arsye bindëse për të mos e bërë këtë. Kjo do të thotë se çdo parashtrim konfidencial duhet të ketë automatikisht versionin e redaktuar publik.

Më 3 nëntor u mbajt një seancë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore kundër z. Sabit Januzi dhe z. Ismet Bahtijari. Gjatë seancës mbi ecurinë e çështjes u diskutuan përditësimet lidhur me përparimin e hetimeve, përkthimin e materialit provues dhe aspekte të tjera që synojnë të sigurojnë administrim efikas të procesit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi gjithashtu një urdhër gojor, me të cilin udhëzoi Prokurorinë të dorëzojë dosjen paraprake deri të premten, 2 shkurt 2024.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 2 nëntor, Administratorja informoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake se z. Januzi ka zgjedhur z. Xhonatan Elistan Ris për Mbrojtës dhe se Administratorja miratoi në mënyrë të kushtëzuar z. Hju Bauden si bashkëmbrojtës të z. Januzi.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

